VENDIM
Nr. 169, datë 28.6.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "NRG POWER" SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "d", 5, pika 1, germa "d", 10, pikat 1, 3 dhe 7 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 935/2 prot., datë 21.6.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "NRG Power" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

Shoqëria "NRG Power" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 674 prot., datë 12.5.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 131, datë 31.5.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "NRG Power" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për shkak se në aplikimin e shoqërisë mungonte një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit, në objektin e veprimtarisë së saj nuk ishte i përcaktuar, furnizimi i energjisë elektrike, veprimtari për të cilën kërkon të licencohet, ndaj u vlerësua të mos fillojë procedura për licencimin e shoqërisë "NRG Power" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim, me shkresën nr. 674/1 prot., datë 6.6.2022, ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen si më sipër, duke i dhënë udhëzimet përkatëse, në zbatim të nenit 10, pika 7, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe sqaroi shoqërinë, se, në rast se do të sillte një aplikim të ri për licencim, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsideroheshin të vlefshme për aplikimin e ri.

- Shoqëria "NRG Power" sh.p.k., brenda afatit 1-mujor, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 674/2 prot., datë 10.6.2022, ka riparaqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, duke depozituar dhe dokumentacionin shtesë.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për llogari të ERE-së, bazuar në përcaktimet e aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Në zbatim të rregullores, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik dhe administrativ; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin, si vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, germat "a", "b";

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "e" dhe "g";

- dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d";

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.7, germat "a", "b", "c", "d", "f" dhe "g".

- Rezulton se nuk është plotësuar ende dokumentacioni si vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1:

- germa “c” (të dhëna për aplikuesin).

- Shoqëria duhet të plotësojë formularin me deklaratat përkatëse, në lidhje me njohjen me kuadrin ligjor dhe angazhimin për zbatimin e tij.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2:

- germa “d” (Vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).

- Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin e gjykatës për adminsitratorin e saj.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë furnizimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.7:

- germa “e” (Sistemin IT i krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi).

- Shoqëria duhet të depozitojë sistemin IT.

- germa “h” (Të dhënat për klientët dhe energjinë e furnizuar).

- Shoqëria duhet të paraqesë në ERE informacion në lidhje me klientët dhe energjinë e furnizuar.

- germa “i” (Niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët).

- Shoqëria duhet të paraqesë informacion për sa kërkon kjo pikë e rregullores.

- Në vijim të vendimit të Bordit nr. 131/2022, për mosfillimin e procedurës për licencim e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, rezulton se ajo ka depozituar brenda afatit të përcaktuar informacion dhe dokumentacion plotësues, i cili konsiderohet i mjaftueshëm për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti